



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0638

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së OE Naim Shuki B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me uniforma verore për QMU-së Lot 1 dhe Furnizim me uniforma për punonjësit e QKMF-se Lot 2 Ritender” me numër të prokurimit 616-25-3456-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, më 29.08.2025, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e Naim Shuki B.I. me nr. 2025/0638, e datës 11/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me uniforma verore për QMU-së Lot 1 dhe Furnizim me uniforma për punonjësit e QKMF-se Lot 2 Ritender”, me numër të prokurimit 616-25-3456-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me uniforma verore për QMU-së Lot 1 dhe Furnizim me uniforma për punonjësit e QKMF-se Lot 2 Ritender”, me numër të prokurimit 616-25-3456-1-2-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.04.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e

prokurimit “Furnizim me uniforma verore për QMU-së Lot 1 dhe Furnizim me uniforma për punonjësit e QKMF-se Lot 2 Ritender”, me numër të prokurimit 616-25-3456-1-2-1.

Autoriteti Kontraktues Ka Zbatuar Procedurë Të Hapur Lloji I Kontratës: Furnizim, Vlera E Parashikuar E Kontratës: Lot 1- 50,000.00 €.

Me 11.07.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë për Lot 1- OE “ Sodex Group Sh.P.K ” .

Me 25.06.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 01.07.2025 AK e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.07.2025, OE Naim Shuki B.I., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0638, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të aktivitetit të prokurimit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Naim Shuki B.I., janë parashtruar si në vijim: Në baze të LPP-se, neni 108/A të ligjit 04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.05-L68 dhe ligjin 5/L-092, tek B58 Njoftim Mbi vendimin e autoritet kontraktues (B42 - Letër standarde për [tenderuesin] e eliminuar dhe ata të sukseshëm) ka ndollur një gabim ndaj kompanisë tone që thuhet se jemi diskualifikuar për këtë arsye: Mostrat e dorëzuara nga OE Naim Shuki Bi Plotson të gjitha kërkesat e ANEKSIT 1 DTKurse AK arsyet për eliminimin e OE-s Naim Shuki BI ka bërë pa arsye dhe pa baze (se paku një foto) Arsyje e eliminimit është pika 1 për Pantolla Verore i plotësojnë të gjitha kërkesat e standardeve ISO bashkëngjitura në Dosje Pika 2 Kepucat plotësojnë të gjitha kërkesat e Aneksit 1 DT, Arsyje për eliminim nuk e baze (se paku një Foto) Kurse në OE Naim Shuki BI jemi eliminuar pa baze ligjore pasi që të gjithë mostrat plotësojnë kërkesat e Aneksit 1 TD Pasi që kemi pranuar Vendimin e AK-s e cila është OE SODEX shpërblyer me kontratë dhe kemi bërë kërkesë për qasje në dokumenta dhe Mostrat kemi hasur se OE SODEX nuk është përgjegjshëm për arsye se: 1. Mostrat e dorëzuara nuk janë në harmoni me katalogun dhe me specifikat teknike të dosjes së tenderit të Aneksit 1. MOSTRAT E DORZUAR NUK E NEJETE ME ATË KATALOGUT 2. Uniformat e dorëzuara nuk janë vërtetuar me certifikatë ISO 9001 2015 Prodhuesit (Certifikatë është për një kompani tjetër dhe afati skaduar, VOLPI S.r.l. Kurse uniformat janë RESUCE PROTECH) 3. Gjithashtu edhe Certifikatë për OEK Tex nuk është për kompaninë e cila është dorëzuar Mostrat është për një kompani tjetër (Certifikatë është për një kompani tjetër Weavi ng Molteni Palmira S.R.L Kurse uniformat janë RESUCE PROTECH) 4. Ngjyra e uniformave Jelek dhe Pantolla është kërkuar sipas Aneksi 1 TD ngjyre e kuqe Kurse OE ka ofruar ngjyre tjetër 5. Kepucat është kërkuar të ketë në kuti duhet të jenë deklarata e

prodhuesit si dhe udhëzimet për mirëmbajtje Kurse OE ka ofruar Broshuren për Qizme të gjata e cila keputat e ofruar në mostra nuk plotëson kushtet e Aneksi 1 TD sipas Broshurës Kërkesa e Aneksi është Lartësia e keputeve të jetë 8.5 deri 10 cm Kurse OE ka ofruar një lartësi 10 cm. Mostra e dorëzuar Jelevat nuk plotëson Kushtin Aneksi 1 TD: Aneksi 1 TD: Jelevat duhet të ketë xhup për vendosjen e radios në anën e majtë të kraharorit, me lartësi 13-15 cm me një pjesë me rrjetë për dëgjimin e radios, xhupi i radios duhet të ketë mbyllje me velkro nga lart Xhupi është në anën e djathtë dhe pjesa me rrjetë nuk është vendosur Aneksi 1 TD: Jelevat duhet të ketë një shirit horizontal reflektiv ndërmjet xhepave të poshtëm dhe të lartëm dhe që vazhdon në gjithë perimetrin e trupit (edhe në pjesën e pasme), me lartësi 6-8 cm. Shiriti është 5 cm Aneksi 1 TD: Jelevat duhet të ketë dy shirita vertikalë reflektiv me gjerësi 4-6 cm, që nisen nga pjesa e përparme e shiritit horizontal, duke kaluar anash xhepave të sipërm, drejt shpatullave dhe përfundojnë në pjesën e pasme të shiritit horizontal Shiriti Vertikal në pjesën e përparme nuk është vendosur dhe nuk kalon anash xhepave është vetëm në pjesën e pasme. 7. Maica më e mëngje shkurta nuk është ekstra e gjatë dhe Jaka është 2 cm kurse është kërkuar 2.5 cm Aneksi 1 DT • Ekstra e gjatë • Jake 2.5 cm, jake me densitetin të lartë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Operatori ekonomik "Naim Shuki BI" (tutje "parashtruesi") me datë 25.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me uniforma për QMU-së Lot 1 dhe Furnizim me uniforma për punonjësit e QKMF-së Lot 2 Ritender" me nr. të prok. 616-25-3456-1-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in meritum) të kërkesës.

Në kuti duhet ndodhet nënfaqja e daljes me ç'të njëjtën. Secila palë e këpucëve në kuti duhet të ketë një broshurë e cila përmban informacionet për përshtatje në mbathje, udhëzimet e mirëmbajtjes, informatat për standardet, deponim dhe përkrahjet tjera. Materiali i jashtëm: Tekstil i kombinuar me mikrofibra të papërshkueshëm nga uji, me ajrosje. Pjesa e brendshme duhet të jetë nga materiali 3 shtresor, i laminuar, i papërshkueshëm nga uji dhe shumë i përshkueshëm nga ajri. Rezistente ndaj abrazionit me rehati optimale klimatike, fleksibile për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm. Astari duhet të jetë me material tre shtresor të laminuar, të papërshkueshëm nga uji, të ngjitur në mënyrë të përhershme, rezistencë në gërryerje, konsum, dhe materiali fibrik i pathurur. Ky material duhet të jetë shumë i përshkueshëm nga ajri i cili nxjerr çdo lagështi të brendshme. Mburoja e këpucëve me tharje të shpejtë thith djersën dhe siguron një efekt anti-bakterial. Kjo do të thotë që nuk mund të lindin erëra të pakëndshme.

Shtresa 1: shtresa e jashtme pëlhurë e thurur,

Shtresa 2: membranë bi komponent bazuar në ePTFE,

Shtresa 3: tekstil 100% i thurur.

Fortësi kundër gërryerjes (në përputhje me EN ISO 20344, seksioni 6.12):

Në thatësi: $\geq 100,000$ cikle

Në lagështi: $\geq 50,000$ cikle.

Përshkueshmëria e avujve të ujit (WVP): $\geq 10 \text{ mg/cm}^2\text{xh}$,

Rezistenca ndaj depërtimit të ujit: 2000 mbar.

Shtresa e jashtme (sholla) e qëndrueshme e bërë nga një përzierje me cilësi të lartë gome. E bërë nga goma, rezistente ndaj vajit, benzinës, nxehtësisë dhe të ftohtit sipas standardeve ndërkombëtare EN ISO 20347:2012. Për të mos rrëshqitur, shok-absorbuese, shtresa e jashtme (sholla) gome me mbrojtëse në çarje.

Shtresa e poshtme duhet të jetë gomë e fortë e qëndrueshme dhe të ketë veti të mira kundër rrëshqitjes, duhet t'i ketë edhe shtresën dy dhe shtresën tre që janë me material PU direkt të injektuara. Shtresa dy shërben për amortizim sa më të mirë për këmbë dhe shtresa tre për lidhje sa më të mirë me pjesën e sipërme. Gomë me rezistencë të lartë ndaj gërryerjes e cila duhet të garantojë funksionalitetet e mëposhtme:

- a) Vetë të larta për largimin e lagështisë në zonën e gishtërinjve dhe thembrave,
- b) Kthim të lartë të energjisë dhe mbështetjes së këmbës,
- c) Izolim i mirë ndaj nxehtësisë dhe të ftohtit,
- d) Vetë optimale të ecjes dhe rrotullimit.

Shtroja e brendshme: e rehatshme, qetësuese, rezistuese ndaj lagështisë, antibakteriale, mund të lahet në 30 °C, formë të veçantë në thembra për mbështetje të mirë të këmbës. Shkumë PUR e laminuar me shtresë ajrosëse poliestër, rezistuese ndaj lagështisë, me mbështjellës shumë të mirë në futje të këmbës brenda. Rezistencë ndaj gërryerjes, materiali i sipërm duhet të përballojë më shumë se 200.000 cikle në test të thatë dhe 50.000 cikle në test të lagësht sipas DIN EN ISO 12947-2/EN ISO 20347.

Fitingu, lidhëset: Sistem unazash të avancuara rezistente. Lidhëset duhet të kenë vend të veçantë për vendosjen në gjuhë. Lidhëse të rrumbullakëta, rezistuese ndaj ujit, të bëra nga poliestër, diametri (ø): 2.5 - 4 mm. Gjatësia e përshtatshme për modelin. Ngjyra e zezë. Vendi për lidhëset duhet të jetë me unaza plastike, pa metal. 3 palë unaza për shtrëngim për këpucë, unazë ovale afër gjuhës së këpucëve 1 palë për këpucë, 1 pjesë plastike për shtrëngim të shpejtë, 1 konektor për lidhëse të këpucëve.

Standardet për tërë këpucën sipas EN ISO 20347:

Rezistenca ndaj kontaktit në nxehtësi: HRO,

Izolimi i nxehtësisë (rritja e temperaturës): HI,

Izoluese i të ftohtit: CI,

Rezistente ndaj ujit: WR,

Rezistenca ndaj karburantit të naftës: FO,

Rezistenca ndaj rrëshqitjes: SRC.

Madhësia: 35-50 EU,

Ngjyra: e zezë.

Garancioni minimum 1 vit: Papërshkueshmëria nga uji, qepje të vullkanizuara (salduara). Vullkanizimi i qepjes duhet të kalojë testin e presionit prej 1 bar për së paku 5 min.

Ambalazhimi: Këpucët duhet të jenë të paketuara në kuti në të cilën duhet të jenë deklarata e prodhuesit si dhe udhëzimet për mirëmbajtje. Në pjesën e përparme të kutisë të jetë e vendosur: Emri i prodhuesit, Lloji i prodhimit, Madhësia e numrit. Prodhuksi duhet të jetë i certifikuar sipas EN ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) dhe EN ISO 14001:2015. Këpucët duhet të prodhohen dhe testohen sipas EN ISO 20347:2012. Mostra obligative.

Komisioni i vlerësimit konstaton se për këtë mostër nuk i përmbushë kërkesat sipas specifikacionit teknik sepse: Sistemin e lidhësve nuk e kanë të avancuar sipas kërkesës (duhet të kenë sistem të avancuar të lidhëseve), OE ka ofertuar lidhëse të thjeshta që është në kundërshtim me kërkesën, nuk janë për terrene malore sipas kërkesës si dhe ambalazhimi i këpucëve nuk e përmban deklaratën e prodhuesit si dhe udhëzimet për mirëmbajtje sipas kërkesës, Garancinë minimum 1 vit, Papërshkueshmëria nga uji, Qepje të vullkanizuara (salduara), Vullkanizimi i qepjes duhet të kalojë testin e presionit prej 1 bar për së paku 5 min, andaj komisioni konstaton se për aktivitetin e prokurimit Lot I OE është i papërgjegjshëm.

Lidhur me pretendimet ankimore është gjetur se parashtruesi nuk i ka kontestuar fare arsyet për eliminimin e ofertës së tij nga aktiviteti i prokurimit. Të gjitha pretendimet ankimore janë parashtruar kundër tenderuesit të rekomanduar. Rrjedhimisht parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në raport me tenderuesin e rekomanduar përderisa vet oferta e parashtruesit është eliminuar si e papërgjegjshme. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".

Sidoqoftë edhe pretendimet e parashtruesit sipas të cilave mostrat e tenderuesit të rekomanduar nuk janë në rregull, pas shqyrtimit të tyre është gjetur se pretendimet janë të pabazuara pasi që mostrat janë dorëzuar sipas ST/DT dhe si të tilla janë verifikuar nga komisioni vlerësues. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0638, ndërsa me datë 21.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0638, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit të tyre, provat si dhe raporti i ekspertit

shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OENaim Shuki B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0638 ka vlerësuar si në vijim:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tenderit, kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës së paraqitur në OSHP, rezulton se Operatori Ekonomik ankues nuk ka paraqitur asnjë pretendim në kërkesën për rishqyrtim lidhur me vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e tij nga procedura. Në vend të kësaj, OE është fokusuar vetëm në kundërshtimin e vendimit për përzgjedhjen e OE-së së rekomanduar për kontratë.

Mos kundërshtimi i vendimit për eliminimin e tij nënkupton që OE është pajtuar me këtë vendim, dhe si i tillë, referuar nenit 4.1.26 të Ligjit për Prokurimin Publik, nuk mund të konsiderohet si palë me interes material në këtë procedurë.

Gjithashtu, vërehet se në ankesën e dorëzuar në OSHP, OE ankues ka shtuar pretendime të reja, përfshirë ato që lidhen me vlerësimin e mostrave dhe përmbushjen e standardeve ISO, të cilat nuk janë përmendur më parë në kërkesën për rishqyrtim. Sipas nenit 64.2 të Rregullores për Prokurim Publik, pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – dhe rrjedhimisht, pretendimet e reja janë të papranueshme për shqyrtim në këtë fazë.

Bazuar në sa më sipër, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar, ndërsa OE ankues të konsiderohet si palë pa interes në këtë procedurë të prokurimit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me uniforma verore për QMU-së Lot 1 dhe Furnizim me uniforma për punonjësit e QKMF-se Lot 2 Ritender”, me numër të prokurimit 616-25-3456-1-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Naim Shuki B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: